


DEMOKRACINË E RUAJTMË DHE E MBAJTMË



NE POPULLI


UDHËHEQJA E SHTETIT, NË DUART TONA

ALBIN (10), FLLANXA (10), ERION (10), ERINA (10), DIAR (11), MIRADIJE (10), ALTIN (11)



Më poshtë mund të lexoni një tregim për „Nënë Demokraci“

Na ishte një herë një grua, e cila kishte jetuar shumë gjatë. Ajo vlerësohej shumë nga të gjithë personat që e njihnin. „Nëna Demokraci“ kishte disa fëmijë, të cilët kishin po aq vlera sa edhe vetë nëna e tyre. Ata



quheshin: Respekti, Solidariteti, Paqja, Barazia, Toleranca dhe Liria.

Respekti ishte një djalë, i cili sillej shumë mirë me të tjerët dhe nuk ndërhynte në biseda kur dikush tjetër fliste. Solidariteti ishte djalë shumë human, i cili u dilte në ndihmë personave në nevojë. Paqja, sa herë që haste në përleshje të njerëzve, tentonte t'i qetësonte ata. Kurse, Barazia, i konsideronte të gjithë shokët e shoqet e saja të barabartë dhe nuk bënte dallime. Toleranca ishte një vajzë shumë modeste, e cila nuk i paragjykonte të tjerët nga raca, feja, apo etnia. Ndërsa,

Liria ishte vajzë e cila nuk hezitonte të bënte pyetje, t'i shprehte idetë e saja apo të shkonte ngado që ajo dëshironte. Familja e Demokracisë ishte familje ideale, të cilën secili prej nesh do ta dëshironte ta kishte.

Ky ishte tregimi ynë imagjinar për demokracinë. Ne e paraqitëm demokracinë, ashtu siç e ndjemë. Edhe Kosova është shtet demokratik që nga viti 2008. Prej asaj kohe, qytetarët e Kosovës, me t'i mbushur 18 vjet, dalin në zgjedhje dhe votojnë për përfaqësuesit e tyre, të cilët janë deputetët.

Posa të rritemi, edhe ne do ta bëjmë të njëjtën gjë sepse vetë domethënia e fjalës demokraci është udhëheqje e popullit. E me anë të votës, ne jemi pjesë e vendimmarrjes.

Të gjithë ju që dëshironi të keni një jetë të lumtur, merreni shembull tregimin tonë me „Nënë Demokraci“ dhe bazohuni në vlerat që i ka ajo.




Arsyeja e buzëqeshjes sonë, ndjenja që na jep demokracia

NJË VOTË BËN NDRYSHIMIN

FLORENTINA (10), HAXHERE (10), RIAD (10), ERDIN (10), MERITON (10), ENGJËLL (10), AMELA (10),

ELONA (10)



Qytetarë të dashur, a e dini se ju keni vlerë të madhe në një shtet demokratik, sepse vota juaj mund të ndryshoj shtetin në të cilin jetoni?

Vota bën ndryshimin! Kjo fjali dëgjohet pothuajse çdo ditë nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Por, a keni menduar ndonjëherë se si mund të bëjë vetëm një votë ndryshim? Këtë e mësuam sot edhe ne, në vizitën tonë në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“.



Demokracia më jep vlerë

Gjatë punës sonë, ne e diskutuam këtë dhe mësuam se zgjedhjet janë zemra e demokracisë. Ne kuptuam se e drejta për të votuar i jep vlerë dhe fuqi sistemit më të mirë të qeverisjes, që është i njohur si demokraci. Kemi pasur edhe një shembull shumë të mirë për ta kuptuar rëndësinë e një vote. Ky rast kishte të bënte me zgjedhjet e kaluara lokale që janë mbajtur në Kosovë. Në këto zgjedhje, vetëm për një votë fitoi një

kandidat për assemble komunale, duke shënuar kështu një votë më shumë se kandidatët e tjerë. Këtë shembull, na e tregoi një shoqe e klasës, e cila tashmë kishte kuptuar rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje. Ajo na ndihmoi shumë me këtë shembull dhe na bëri të vetëdijshëm se vetëm një votë e jona mund të bëjë ndryshime të mëdha.

Raste të tilla të ndryshimit të shënuar vetëm nga një votë ka pasur shumë. Prandaj, ne votuesit e të ardhmes jemi duke e pritur me padurim kohën kur do ta arrijmë moshën 18 vjeçare. Atëherë, do ta kemi të drejtën për të vendosur vetë për udhëheqësin e shtetit tonë. Po ashtu, ne mendojmë se vendimi ynë do të sjellë ndryshim, pasi që ne do të mendojmë mirë paraprakisht se kë ta votojmë si përfaqësues të popullit. Mos harroni se votimi është proces shumë i rëndësishëm. Pjesëmarrja në të do të thotë përkushtim ndaj shtetit tuaj. Prandaj, ndërtojeni atë me vlera demokratike.



Në demokraci vendosim së bashku

FUNKSIONET E INSTITUCIONIT MË DEMOKRATIK

ENSAR (10), OMAR (10), AURON (10), ERDRIN (9), DERJA (10), VIOLETA (10), MUHAMED (10),

ELJESA (10)



Në këtë artikull do të flasim për Kuvendin dhe rëndësinë e ligjeve në jetën tonë

Të dashur lexues, a e dini se ekziston një ligj i caktuar i cili mbron ushqimin që ne e konsumojmë? Sipas këtij ligji, të gjithë ne qytetarët duhet të ushqehemi me produkte të shëndetshme. Kjo vlen për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa asnjë dallim, racor, fetar, apo kombëtar. Nga kjo kuptojmë se ushqimi që ne e konsumojmë është i mbrojtur.

Mirëpo, a e dini prej nga ka ardhur ky ligj? Ligji në fjalë është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në institucionin më demokratik të Kosovës. Ky institucion është Kuvendi. Në këtë shtëpi të madhe, dalin ligje të ndryshme të cilët përmirësojnë dhe sistemojnë jetën tonë.

Prandaj, Kuvendi është kaq i rëndësishëm dhe kaq i dashur për ne. Ky funksion i Kuvendit njihet si funksioni legjislativ, sepse bën miratimin e ligjeve.

Kuvendi ka edhe funksion tjetër që është funksioni kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon Qeverinë. Ndërkaq, funksioni përfaqësues është funksioni tjetër i Kuvendit, për shkak se deputetët të cilët punojnë në Kuvend, na përfaqësojnë neve. Ne i zgjedhim me votat tona.

Janë 120 deputetë, të cilët flasin në emrin tonë dhe marrin vendime për neve. Ne kemi shumë ligje të tjera falë të cilave gëzojmë të drejta, gëzojmë siguri dhe ndihemi të mbrojtur. Gjithsesi se nuk duhet harruar rolin tonë në demokraci. Ne e ndërtojmë atë.



Ne i zgjedhim deputetët, ata flasin në emrin tonë. Është kaq e thjeshtë dhe kaq e drejtë, sa ne u çuditëm kur mësuam këtë fakt



Në demokraci e pranojmë njëri-tjetrin pa dallime race, feje, gjinie, kombësie apo besimi

DEMOKRACIA AKTIVE

VLERA (10), RINESA (10), ENIS (10), ERZA (10), ERIS (10), BLEND (10), FATION (10)



Altini është qytetar aktiv. Ai voton, ndihmon të tjerët, bën punë vullnetare dhe mban ambientin e pastër

Çdo qytetar i Kosovës ka mundësi të aktivizohet dhe të shprehet lirshëm, sepse ne jetojmë në një vend demokratik

Demokracia ka ndihmuar që shumë vende në botë të zhvillohen. Kjo arrihet duke u angazhuar kështu në ndërtimin e shkollave, në sigurimin e të drejtave, në miratimin e ligjeve, etj. Po ashtu, demokracia ka ndihmuar qytetarët të lëvizin dhe të flasin lirshëm.


Pasi që shteti demokratik na ofron kushte të mira për jetesë dhe zhvillim, atëherë ne duhet t'i shfrytëzojmë këto mundësi dhe të bëhemi qytetarë aktiv. Njerëzit tregohen qytetarë aktiv duke bërë vepra të mirë që ndihmojnë shtetin. Nëse ata respektojnë njëri-tjetrin dhe ndihmojnë të tjerët, atëherë ata patjetër që janë qytetarë aktiv.

Një shembull i një qytetare aktive botërore është Nëna Terezë. Ajo ka qenë një grua aktive e cila ka ndihmuar shumë fëmijë nëpër botë. Pasi që ajo tregoi kujdes të madh ndaj fëmijëve, u shpërblye me çmimin Nobel për paqe. Shembuj se si ne jemi qytetarë aktiv kemi

çdo ditë. Mund të solidarizohemi me të tjerët dhe t'iu ndihmojmë atyre që kanë nevojë. Një ditë një i moshuar me nevoja të veçanta, nuk kishte mundësi të lëvizte në trotuar. Erisi me shokët e tij në momentin që e kanë vërejtur i kanë ndihmuar të moshuarit që të shkojë në shtëpi. Kjo është pak, por nëse secili prej nesh



mendojmë pozitivisht dhe iu ndihmojmë njerëzve në nevojë, atëherë bota do të jetë një vend më i mirë. Aktiv mund të jemi edhe duke bërë punë vullnetare, duke votuar, nënshkruar peticione, etj.



E pastër siç duhet të jetë



Gazetarët e rinjë të këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Mustafë Venhari“
Klasa: V-4
Vendi: Vushtrri